



**V E N D I M**

**Nr. 5 Date 22.1. 2009**

**PER FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DISA SHTESA DHE  
NDRYSHIME NE RREGULLOREN PER KRITERET E DHENIES  
DHE HEQJES SE STATUSIT TE KLIENTIT TE KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 9, dhe 48 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 18 pika 1, germa g), dhe 40, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s, nr.44, date 24.07.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.1.2009, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si dhe të Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren për kriteret e dhenies dhe heqjes së statusit të Klientit të Kualifikuar ,

**Vendosi :**

1. Fillimin e procedurave për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren për kriteret e dhenies dhe heqjes së statusit të Klientit të Kualifikuar
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, për përpunimin e ndryshimeve në Rregulloren “Për kriteret e dhenies dhe heqjes së statusit të Klientit të Kualifikuar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

**VENDIMIN**  
**Nr. 5 Date 22.1.2009**

**PER FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DISA SHITESA DHE  
NDRYSHIME NE RREGULLOREN PER KRITERET E DHENIES  
DHE HEQJES SE STATUSIT TE KLIENTIT TE KUALIFIKUAR**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Bujar Nepravishta</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____